

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**  
**Nr. 132, datë 8.9.2023**

**PËR NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR IDENTIFIKIMIN,  
REFERIMIN, MBROJTJEN DHE RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE  
TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 10.11.2021, “Për një shtesë në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022’, të ndryshuar”,

**UDHËZOJMË:**

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në vijim referuar si “Autoriteti Përgjegjës”.

2. Autoriteti përgjegjës të ketë këtë përbërje:

a) Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme – kryetar;

b) 1 (një) përfaqësues nga Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

c) 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

d) 1 (një) përfaqësues nga Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

e) 1 (një) përfaqësues nga Sektori kundër Krimit Kibernetik, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar;

f) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme – anëtar;

g) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – anëtar;

h) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës – anëtar;

i) 1 (një) përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror – anëtar;

j) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit – anëtar;

k) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive – anëtar;

l) 1 (një) përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore – anëtar;

m) Kryetari i Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (KKSAT) – anëtar.

3. Në mbledhjet e Autoritetit Përgjegjës ftohen të jenë të pranishëm përfaqësues nga Prokuroria kompetente dhe përfaqësues nga anëtarë të tjerë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, në varësi të nevojave për mbështetje dhe ekspertizë, sipas rasteve që do të trajtohen.

4. Autoriteti Përgjegjës është struktura mbështetëse e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në procesin e identifikimit, referimit për ndihmë, mbrojtje, riintegrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, në përputhje me procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

5. Autoriteti Përgjegjës ndjek regjistrimin dhe raportimin periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të identifikuar dhe të referuara nga institucione shtetërore dhe organizatat në përputhje me procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

6. Autoriteti Përgjegjës hedh dhe administron informacionet në Bazën Kombëtare të të Dhënave për Viktimat e Trafikimit, sipas rubrikave përkatëse, mbi çdo rast të identifikuar dhe të referuar.

7. Autoriteti Përgjegjës mbledhet në mënyrë periodike të paktën një herë në muaj, në varësi të rasteve të referuara.

8. Koordinimi i veprimtarisë administrative të Autoritetit Përgjegjës ndiqet nga sekretariati, i cili përbëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe specialisti i Sektorit të Antitrafikut në Drejtorinë e Politikave të Antitrafikut dhe Migracionit, në Ministrinë e Brendshme.

9. Sekretariati është përgjegjës për njoftimin e anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës, organizimin e takimeve periodike dhe të takimeve jashtë radhe, sipas nevojave, mbajtjen e korrespondencës me anëtarët, dokumentimin e takimeve dhe të veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Përgjegjës.

10. Sekretariati është përgjegjës për mbledhjen, regjistrimin dhe administrimin e të dhënave që raportohen nga anëtarët e Autoritetit Përgjegjës dhe hartimin e raporteve sipas kërkesave. Raportet e hartuara nga Sekretariati janë objekt vlerësimi dhe miratimi i të gjithë anëtarëve të Autoritetit Përgjegjës.

11. Autoriteti Përgjegjës i raporton, në mënyrë periodike një herë në muaj, për gjithë veprimtarinë e tij, drejtorit të përgjithshëm dhe zëvendësministrit në Ministrinë e Brendshme, të cilët mbulojnë fushën e përgjegjësisë së antitrafikut.

12. Të merren të gjitha masat për krijimin, plotësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe financimit të nevojshëm, në drejtoritë përkatëse të këtyre institucioneve, për të trajtuar referimet e të gjitha viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe për të kryer të gjitha funksionet e tjera të bashkërendimit dhe raportimit, të cilat iu kërkohen sipas këtij udhëzimi.

13. Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim, mund të trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, që mund të lidhin për këtë qëllim.

14. Ngarkohet Autoriteti Përgjegjës të hartojë rregulloren e veprimit dhe të funksionimit të tij, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

15. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Punëve të Jashtme, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nr. 3799 prot., datë 8.7.2014, "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit", shfuqizohet.

16. Ngarkohet Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
**Taulant Balla**

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME  
**Olta Xhaçka**

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT  
**Evis Kushi**

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
**Ogerta Manastirliu**

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**